

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	67,546,629	5,352,869
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	31,557,691	44,517,469
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	956,015	23,141,108
Inventarë	7	56,960	11,556,439
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	1,964,511	1,245,767
Totali i aktiveve afatshkurtra		102,081,806	85,813,652
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	195,443,599	196,620,982
Aktive afatgjatë jomateriale	9	136,500	370,500
Totali i aktiveve afatshkurtra		195,580,099	196,991,482
Totali i aktiveve		297,661,905	282,805,134
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	2,374,522	10,063,790
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	28,323,676	12,853,077
Detyrime tatimore	12	9,543,610	2,695,534
Të tjera detyrime	13	14,686,536	7,800,372
Totali i detyrimeve afatshkurtra		54,928,344	33,412,773
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	14	-	73,230,882
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	73,230,882
Totali i detyrimeve		54,928,344	106,643,655
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000,000	100,000,000
Rezerva ligjore		10,249,911	10,249,911
Rezerva të tjera		65,911,568	60,092,020
Fitimi i ushtrimit		66,572,082	5,819,548
Totali i kapitalit	15	242,733,561	176,161,479
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		297,661,905	282,805,134

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Green Energy sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	317,531,493	185,619,541
Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar	17	613,240	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	2,639,609	352,457
Total të ardhura		320,784,342	185,971,998
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(172,126,655)	(108,791,164)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	19	(155,775,165)	(94,871,834)
2) Të tjera shpenzime	20	(16,351,490)	(13,919,330)
Shpenzime të personelit	21	(49,091,566)	(49,157,723)
1) Paga dhe shpërblime		(44,354,358)	(44,277,220)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(4,737,208)	(4,880,503)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(19,742,715)	(16,951,665)
Provizione dhe zhvleresime	22	(1,000,000)	(1,127,771)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(2,331)	(12,000)
Shpenzime financiare		128,595	(2,383,647)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	24	128,595	(2,383,647)
Fitimi/humbja para tatimit		78,949,670	7,548,028
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(12,377,588)	(1,728,480)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	25	(12,377,588)	(1,728,480)
Fitimi/humbja e vitit		66,572,082	5,819,548
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		66,572,080	5,819,548

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBANIAN GREEN ENERGY Sh.p.k
Rr.A. Toptani, Toççe Drin, Ap.61
TIRANE

Albanian Green Energy sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Pozicioni financiar më 1 janar 2017	Kapitali i nënshkruar 100,000,000	Rezerva Statutore dhe Ligjore 9,139,485	Rezerva të tjera 38,993,934	Fitim / Humbja e vitit 22,208,512	Totali 170,341,931
Fitim/humbja e vitit				5,819,548	5,819,548
Transferim i fitimit të vitit në rezerva		1,110,426	21,098,086	(22,208,512)	-
Dividendë të paguar					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000,000	10,249,911	60,092,020	5,819,548	176,161,479
Fitim/humbja e vitit				66,572,082	66,572,082
Transferim i fitimit të vitit në rezerva			5,819,548	(5,819,548)	-
Dividendë të paguar					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000,000	10,249,911	65,911,568	66,572,082	242,733,561

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Albanian Green Energy sh.p.k më 13/03/2019 dhe janë firmosur si më poshtë.



Eugenio Rosatto
ALBANIAN GREEN ENERGY Sh.p.k.

Rr. A. Topllani, Torre Drin, Ap.61

EUGENIO ROSATTO



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	66,572,082	5,819,548
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	280,404	2,227,227
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(3,808,081)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	19,742,715	16,951,665
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	35,144,871	(14,010,835)
Rënie/(rritje) në inventarë	11,499,480	(11,536,399)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	32,784,012	(44,738,153)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(718,744)	-
Tatim mbi fitimin e paguar	(8,569,507)	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(509,224)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	152,418,008	(45,286,947)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(18,331,332)	(38,709,078)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(18,331,332)	(38,709,078)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(69,577,882)	73,230,882
Interes i paguar	(74,159)	(622,603)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(69,652,041)	72,608,279
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	64,434,635	(11,387,746)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	5,352,868	17,206,797
Efekti i luhatjeve të kursit të kembimit	(2,240,874)	(466,183)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 67,546,629	5,352,868

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është krijuar më 27/12/2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008, "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është shoqëri shqiptare me ortak Essegei SpA shoqëri e së drejtës italiane që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 Lek. Administrator i shoqërisë është Z. Eugenio Rossato.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Ap.61. Tiranë. Shoqëria është regjistruar në organet tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K71624027U.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi i energjisë elektrike.

Në 31 dhjetor 2018 shoqëria ka 38 punonjës (2017: 39)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	110.10

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlërësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit në %
Ndërtimore	5
Makineri e Pajisje	20
Mjete transporti	20
Pajisje zyre	20
Pajisje kompjuterike	25
Të tjera	20

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësisë ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

Bu

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	67,541,235	4,964,899
Llogari rrjedhëse	67,541,235	4,964,899
Mjete monetare në arkë	5,394	387,970
	67,546,629	5,352,869

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
OSHEE për fatura të pranuar	-	16,278,943
OSHEE për fatura në proces çertifikimi	31,557,691	28,238,526
	31,557,691	44,517,469

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të drejta për tu arkëtuar nga proceset gjyqësore me KESH	-	16,919,280
Paradhënie për personelin	7,341	309
Tatimi mbi fitimin i mbingarkuar	-	3,466,149
Shteti TVSH e zbritshme	-	1,613,201
Detyrim doganor i mbingarkuar	8,210	1,705
Garanci te ndryshme	240,464	240,464
Tarife aplikimi ERE per licences e re	700,000	900,000
Pagesat e kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	995,387	995,387
Zhvlerësim i pagesave të kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	(995,387)	(995,387)
Takse gjyqësore 1% per ceshtjen ndaj OSHEE	527,771	527,771
Provizion i krijuar per shpenzimet gjyqësore 1%	(527,771)	(527,771)
Taksa Bashkia Selenice	1,600,000	600,000
Provizion i krijuar per ceshtjen e taksave lokale Bashkia Selenice	(1,600,000)	(600,000)
	956,015	23,141,108

7. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Materiale të para	-	11,271,759
Lëndë djegëse	56,960	284,680
	<u>56,960</u>	<u>11,556,439</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të shtyra	1,901,018	1,245,767
Parapagime per blerje	63,493	-
	<u>1,964,511</u>	<u>1,245,767</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata material

	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Asete në proces	Totali	AAMJ
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2017	158,012,833	272,752,182	2,571,295	4,040,664	3,827,900	441,204,874	1,755,700
Shtesa	25,600,567	12,863,807	-	244,705	(3,827,900)	38,709,079	-
Riklasifikim	3,827,900					-	-
Pakësime						-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	187,441,300	285,615,989	2,571,295	4,285,369	-	479,913,953	1,755,700
Shtesa	920,157	14,419,049	963,254	1,412,072	616,800	18,331,332	-
Transferime						-	-
Pakësime						-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	188,361,457	300,035,038	3,534,549	5,697,441	616,800	498,245,284	1,755,700
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2017	34,662,415	226,735,401	1,917,020	3,260,468	-	266,575,304	1151200
Amortizimi i vitit	6,635,611	9,655,074	130,855	296,124		16,717,664	234000
Pakësime						-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	41,298,026	236,390,476	2,047,875	3,556,592		283,292,970	1,385,200
Amortizimi i vitit	7,314,224	11,339,854	249,172	605,465		19,508,715	234,000
Pakësime						-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	48,612,251	247,730,330	2,297,047	4,162,057		302,801,685	1,619,200
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2017	146,143,273	49,225,513	523,420	728,777	-	196,620,983	370,500
Gjendja më 31 dhjetor 2018	139,749,206	52,304,708	1,237,502	1,535,384	616,800	195,443,600	136,500

Rn

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj furnitorëve për fatura të pranuar	2,204,356	9,580,825
Detyrime ndaj furnitorëve për fatura të pambërritura	170,166	482,965
	<u>2,374,522</u>	<u>10,063,790</u>

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (afatshkurtëra)

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj paleve të lidhura	28,323,676	12,853,077
	<u>28,323,676</u>	<u>12,853,077</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrimi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	663,308	711,530
Detyrimi për Tatimin mbi të Ardhurat Personale	765,493	713,828
Detyrimi për Tatimin në burim	1,595,230	1,270,176
Detyrimi për TVSH-ne	2,711,498	-
Detyrime për Tatim Fitimin	3,808,081	-
	<u>9,543,610</u>	<u>2,695,534</u>

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për Pagën Neto	3,194,136	3,703,360
Detyrime për Taksën e Shfrytëzimit të ujit dhe të tjera	11,183,330	3,880,106
Detyrime për Taksën rregullatore të E.R.E.-s	309,070	216,906
	<u>14,686,536</u>	<u>7,800,372</u>

14. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (afatgjata)

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura (afatgjata) më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Financime Balkan Green Energy	-	6,755,882
Financime ortakut Essegei s.p.a	-	66,475,000
	<u>-</u>	<u>73,230,882</u>

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku ESSEGEI S.p.A shoqëri e së drejtës italiane më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018				31 dhjetor 2017			
	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%
ESSEGEI spa	1,000,000	1,000	100,000,000	100%	1,000,000	1,000	100,000,000	100%
	1,000,000		100,000,000	100%	1,000,000		100,000,000	100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2018 në vlerën 66,572,079 LEK (2017: 5,819,548 LEK).

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike	317,531,493	168,700,261
Korrigjim i cmimit të shitjes së energjisë elektrike, viti 2013	-	8,710,800
Korrigjim i cmimit të shitjes së energjisë elektrike, viti 2014	-	8,208,480
	317,531,493	185,619,541

Me Vendim nr.143 date 26/12/2014 dhe nr.144 date 26/12/2014 të botuar në fletoren Zyrtare nr.215 datë 28 Janar 2015, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike kishte rishikuar çmimin unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrale ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15MW përkatësisht për vitin 2013 dhe 2014 nga 7.77 Lek/kWh në 7.53 Lek për kWh.

"AREA, ndaj vendimeve të ERE -s Nr. 143 dhe Nr. 144 date 26.12.2014 për rishikimin e çmimit paraqiti një padi më 3.02.2015 pranë Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 2192 datë 16.02.2015 vendosi të aprovojë masën e sigurimit të padisë ndaj vendimeve të ERE-s. Më 27.03.2015 çështja për shkak të kompetencës u dërgua për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ushtron juridikision fillestar. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin Nr. 24 datë 28.09.2015 rrëzoi kërkesën e AREA -s.

Në kushtet kur vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Nr. 24 datë 28.09.2015 është i formës së prerë dhe i detyrueshem për t'u zbatuar nga palët, nga ana e KESH u kërkua ekzekutimi i këtij vendimi e për rrjedhojë u reflektuan këto ndryshime nëpërmjet saktësisimit të çmimit të shitjes për prodhimin e vitit 2013 dhe 2014. Këto saktësime u bënë efektive në vitin 2017 dhe janë regjistruar në pasqyrat e këtij viti ushtrimor.

AREA në datë 27.10.2015 depozitoi rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 13 qershor 2018 vendosi ndryshimin e vendimit Nr. 24 datë 28.09.2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Kolegji pranoi padinë e palës paditëse duke shfuqizuar vendimin Nr. 143 dhe Nr. 144 date 26.12.2014 të ERE.

Në bazë të këtij vendimi, pavarësisht faktit se KESH deri në datën 31.12.2018 nuk e ka ekzekutuar vendimi për likuidimin e vlerës të saktësimeve të bera në vitin 2017, në pasqyrat e këtij viti janë regjistruar të ardhurat nga korrigjimi i çmimit të shitjes për prodhimin e vitit 2013 dhe 2014.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	403,921,781
Të ardhura nga fitimi i gjyqit në të ardhura deklaruara ne 2017,për efekt TVSH deklaruar në 2017	(16,919,280)
Zbritten autofaturat	(66,688,146)
Zbritten diferencat e kursit përfshirë në zërin "Shpenzime të tjera financiare"	2,639,606
Faturuar rimbursim shpenzimesh pasqyruar në zbritje të shpenzimeve	(350,751)
Të ardhura nga interesat e kamavonesat përfshirë në zërin "Shpenzimeve interesi dhe shpenzime të ngjashme"	(1,818,868)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	320,784,339
Sipas Kontabilitetit	320,784,339
Diferenca	-

17. Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar

Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Prodhimi i AA materiale	613,240	-
	613,240	-

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Fitim nga këmbimet valutore	4,909,784	917,413
Humbje nga këmbimet valutore	(2,270,175)	(564,955)
	2,639,609	352,458

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje materiale te para ndërtimore dhe elektromekanike	17,788,175	3,220,763
Lende djegese dhe vaj lubrifikant	3,752,023	3,283,633
Inventar i imet	980,084	355,458
Konsumi i ujit dhe energjise elektrike	897,571	662,749
Qera mjete transporti	658,824	1,976,472
Mirembajtje dhe riparime	36,238,271	18,218,400
Prime te sigurimit për hidrocentralin	4,980,992	4,966,100
Prime te sigurimit për personelin	940,585	75,660
Konsulence teknike dhe manaxheriale	30,733,406	26,557,660
Kontrolli i njohurive teknike	45,000	46,000
Royalties	50,805,040	31,140,427
Shpenzime udhëtimi e dieta	142,900	171,500
Shpenzime për licencen ERE	200,000	100,000
Taksa ERE	309,070	216,906
Taksa e shfrytëzimit te ujit	7,303,224	3,880,106
	155,755,165	94,871,834

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime kancelarie e materiale pastrimi	254,625	272,703
Qira për zyra dhe printer	2,285,570	2,289,722
Mirëmbajtje për zyrat - pajisjet informatike	345,272	268,063
Mirëmbajtje riparime automjetet	1,784,800	1,488,771
Prime të sigurimit automjetet	96,363	57,675
Konsulence ekonomike, juridike e noterizime	3,785,600	2,761,627
Kuota anëtaresimi, pjesëmarrje në panair e abonime	701,203	415,260
Shpenzime për ambientet e përbashkëta e te tjera	245,025	261,412
Shpenzime udhëtimi/dieta	1,314,057	1,330,367
Shpenzime telefoni dhe internet	583,564	619,468
Shpenzime bankare	354,644	206,738
Taksa vendore e të tjera	631,763	411,586
Shpenzime për sponsorizime	129,340	137,000
Shpenzime për pritje	1,352,540	1,169,710
Shpenzime restoranti	1,121,615	998,811
Shpenzime transporti	331,576	-
Shpenzime të tjera	1,033,933	1,230,417
	16,351,490	13,919,330

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për paga dhe shperblime	44,017,858	44,277,220
Shpenzim për punonjës për raste fatkeqësie	336,500	-
Shpenzime për sigurime shoqërore e Shëndetësore	4,737,208	4,880,503
	<u>49,091,566</u>	<u>49,157,723</u>

22. Provizione dhe zhvlerësime

Provizionet dhe zhvlerësimet detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Provizion i krijuar për taksat lokale	1,000,000	600,000
Provizion i krijuar për taksat gjyqesore	-	527,771
	<u>1,000,000</u>	<u>1,127,771</u>

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjoba dhe penalitete	2,331	12,000
	<u>2,331</u>	<u>12,000</u>

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga interesat dhe kamatvonesat e ngjashme	(1,821,125)	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	1,692,530	2,383,647
	<u>(128,595)</u>	<u>2,383,647</u>

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	78,949,670	7,548,028
Total shpenzime të panjohura	3,567,585	3,975,171
Shpenzime pritje & percjellje	398,106	612,851
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	2,331	12,000
Shpenzime zhvlerësi (provizione)	1,000,000	1,127,771
Shpenzime të tjera pa faturë të rregullt tatimore	2,167,149	2,222,549
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	82,517,255	11,523,199
Tatim fitimi @15%	12,377,588	1,728,480
Fitimi/humbja e vitit	66,572,082	5,819,548
Taim fitimi i parapaguar më 1 janar	3,466,149	3,262,227
Parapagime gjatë vitit	5,103,358	1,932,402
Shpenzime tatim fitimi të vitit	(12,377,588)	(1,728,480)
Tatim fitimi i parapaguar/ (për tu paguar)	3,808,081	3,466,149

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Essegei SpA	-	12,829,629	-	75,864,019
CamunAlb Shpk	-	-	-	-
Balkan Green Energy	-	-	-	6,755,881
Camuna Idroelettrica	-	-	-	-
Idro Power Service	-	15,494,047	-	3,464,059
	-	28,323,676	-	86,083,959

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Essegei SpA	-	67,690,511	-	47,343,254
Hydra Energia	-	416,800	-	-
Balkan Green Energy	350,751	7,478	-	1,654,216
Idro Power Service	-	59,333,273	-	34,025,030
	350,751	127,448,062	-	83,022,500

(Vlerat janë në Lek)

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është 413,196 LEK (2017: 1,056,712 LEK).

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.